



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.986/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Bautex” SH.P.K., me NUI: 811430595, me seli në Fshatin Pozheran, në Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.M., avokat në Ferizaj, kundër debitorit “Melodia Projekt” SH.P.K., me NUI: 811023936, me seli në Davidoc Rr “Ibrahim Rugova” p.n, në Shtime, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.197/23 të datës 23.05.2023, të Përmbaruesit Privat Gazmend H. Misini me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 27.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Melodia Projekt” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.197/23 i datës 23.05.2023, i Përmbaruesit Privat Gazmend H. Misini.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor P.nr.197/23 i datës 23.05.2023 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gazmend H. Misini.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Bautex” SH.P.K., ka aprovuar pjesërisht propozimin e kreditorit dhe ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.197/23 të datës 23.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 23032023/M të datës 23.03.2023; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,152.00 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të urdhrin, me kamatë ligjore 8% nga dita e fillimit të

detyrimit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore nën kërcënimin e përbarimit me dhunë, me bllokimin e llogarive si dhe sekuestrimin e mjeteve të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se propozimi për përbarim është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi që debitori ka pranuar urdhrin propozimin dhe urdhrin për përbarim, mirëpo të njëjtës nuk i është bashkangjitur fatura mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përbarimore. Tutje ka theksuar se faturat e përshkruar në propozim nuk janë pranuar nga debitori, i njëjti nuk është në dijeni për kohën e përmbushjes së detyrimit, pasi që nuk disponon me të njëjtat si dhe nuk i janë bashkangjitur urdhrin për përbarim, andaj nga kjo konsideron se faturat janë të pa vulosura dhe të pa nënshkruara nga debitori. Gjykatës i ka propozuar që aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, urdhri përbarimor të shfuqizohet si dhe të obligohet kreditori t'ia paguaj debitorit shpenzimet për përpilimin e prapësimi shumën prej 104.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet për anulimin e urdhrin, pasi që i njëjti është nxjerr konform dispozitave ligjore të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoi si të pabazuar dhe urdhri përbarimor të vërtetohet si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në emër të përpilimi të përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par.

3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaerim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbaerimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaeruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 23032023/M e datës 23.03.2023; i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbaerimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin si dhe vulën e debitorit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbaerimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’ a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaerimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.986/23, datë 27.10.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.